

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS PËR
VITIN 2012

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës në drejtim të:

- Rritjes dhe konsolidimit të pozicionit të Autoritetit për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve;

- Konsolidimit të profilit publik, si institucioni që mbron interesat e biznesit, që zbaton rregullat e lojës së tregut;

- Rritjes së numrit të inspektimeve në tregje, si dhe përmirësimit të teknikave investiguese, duke shfrytëzuar teknologjinë e informacionit;

- Nxitjes së konkurrencës së lirë dhe mbrojtjes së konsumatorëve nëpërmjet ndërmarrjes së hetimit në tregun e ngarkim-shkarkimit të gazit, ruajtjes së sigurisë fizike të objekteve, kartave të telefonisë, transportit të pasagjerëve, me anije apo urban, sigurimeve në sektorin e sigurimeve të detyrueshme dhe ato vullnetare, prokurimet publike, tregtinë me shumicë të artikujve ushqimorë dhe industrialë, importin e produkteve të ndryshme, si dhe në depozitimin e mbeturinave në landfill;

- Plotësimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor, në veçanti atij sekondar, në zbatim të amendimeve të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe për përafrimin e legjislacionit shqiptar me të drejtën europiane në fushën e konkurrencës;

- Përmirësimit të mëtejshëm të instrumenteve të komunikimit, me qëllim rritjen e advokacisë së konkurrencës, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë dhe interaktiv me entet rregullatore e institucionet qendrore;

- Rritjes së bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare për të forcuar rolin e Autoritetit në procesin e integritetit të vendit.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2013 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Plotësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor e nënligjor të institucionit, në përputhje me praktikat e vendeve të tjera dhe direktivat e Bashkimit Europian, në veçanti për nxitjen e konsolidimit e instrumentit të ankesës së operatorëve të tregut;

- Përfundimin e hetimeve të nisura, si dhe zgjerimin e thellimit të hetimeve në tregje, për të eliminuar deformimet e konkurrencës dhe për të mbrojtur konsumatorët;

- Rritjen e efikasitetit të ndërhyrjeve në tregjet ku shfaqen shenjat e kufizimit të konkurrencës, nëpërmjet përsosjes së teknikave investiguese;

- Rritjen e forcës kontrolluese dhe parandaluese të institucionit të konkurrencës ndaj ndryshimeve në strukturat e tregjeve, të rrjedhura nga transaksionet e shitblerjes së aksioneve;

- Rritjen e efektivitetit të instrumenteve investiguese nëpërmjet përsosjes së metodave, mjeteve dhe mënyrave të investigimit, bazuar në teknologjinë e informacionit për zbulimin kryesisht të marrëveshjeve të ndaluara;

- Forcimin e kapaciteteve administrative nëpërmjet rritjes së shkallës së profesionalizmit të personelit, duke konsoliduar instrumentet e analizave ekonomike për të identifikuar ndërlidhjet midis faktorëve që kanë rol përcaktues në një praktikë antikonkurrense.

Kuvendi u kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës:

- Në dhënien dhe shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për monitorimin e tregut dhe hetimin e praktikave që deformojnë konkurrencën në treg;

- Për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

Miratuar në datën 2.5.2013

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)